



Republic of North Macedonia
**Ministry of
Local Self Government**



REVERSING THE COVID CRISIS: MUNICIPALITIES AS DRIVERS OF SUSTAINABLE DEVELOPMENT

Projekti:

“Pas KOVID: Komunat si shtytës të zhvillimit të qëndrueshëm”

Thirrje për projekte për bashkëpunim ndërkomunal

Udhëzimet operative për aplikim

Korrik 2021



BUREAU FOR REGIONAL DEVELOPMENT



Republic of North Macedonia
Ministry of
Local Self Government



REVERSING THE COVID CRISIS: MUNICIPALITIES AS DRIVERS OF SUSTAINABLE DEVELOPMENT

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	3
1. Cili është qëllimi kryesor i thirrjes për projekte?	4
2. Cilat janë fushat prioritare dhe format e pranueshme të bashkëpunimit ndërkomunal në kuadër të kësaj thirrjeje?.....	5
3. Kush mund të aplikojë?.....	5
3.1 Kush nuk mund të aplikojë?.....	5
3.2 Çështje të tjera në lidhje me pranueshmërinë e aplikuesve.....	5
4. Sa është kohëzgjatja e projektit?.....	6
5. Shuma e mjeteve të qasshme në kuadër të thirrjes?	7
6. Cila është korniza kohore për thirrjen?.....	7
7. Ku të dërgoni aplikacionin?.....	7
8. Cilat lloje të projekteve për bashkëpunimit ndërkomunal nuk financohen?	8
9. Cilat shpenzime janë të pranueshme?	9
9.1 Kofinancimi nga ana e NjVL	9
9.2 Pjesëmarrja e Qendrave për zhvillim të rajoneve planore	9
10. Lidhja e kontratave me persona të jashtëm / operatorë ekonomik.....	10
10.1 Të punësuarit në komuna/qendrat	10
10.2 Konsulent të jashtëm	10
11. Shpenzime të cilat nuk mbulohen me grantin	10
12. Evaluimi i projekteve për bashkëpunim ndërkomunal.....	10
13. Si është e organizuar procedura për evaluim dhe zgjedhje?	11
14. Modalitetet për realizimin e projektit	11
15. Menaxhimi dhe monitorimi	12
16. Cilat janë obligimet në lidhje me parashtrimin e raporteve?	12
17. Kriteret për evaluim dhe zgjedhje të aplikacioneve të parashtruara.....	13
17.1 Përshtatshmëria administrative	13
17.2 Përshtatshmëria teknike.....	14



Republic of North Macedonia
**Ministry of
Local Self Government**



REVERSING THE COVID CRISIS: MUNICIPALITIES AS DRIVERS OF SUSTAINABLE DEVELOPMENT

Hyrje

Si rezultat i decentralizimit, komunat fituan numër të madh të kompetencave nga ana e pushtetit qendror. Nga njëra anë, kjo i afroi shërbimet më afër qytetarëve por njëkohësisht për komunat e rriti vëllimin e kompetencave dhe detyrave. Për shkak të mungesës së finanave, kapaciteteve administrative dhe të resurseve njerëzore, ofrimi i pavarur i kompetencave të shtuara paraqet sfidë, veçanërisht për komunat më të vogla.

Kriza e shkaktuar nga virusi KOVID-19 ka rritur presionin mbi autoritetet lokale për tu ballafaquar me pandeminë me fonde të reduktuara komunale dhe nevojën për të vazhduar me ofrimin e shërbimeve, shpesh nën kufizime shtesë të lidhura me pandeminë. Pritet që pandemia të ketë efekte negative afatgjata dhe të konsiderueshme mbi zhvillimin lokal dhe rajonal, si dhe në funksionimin dhe financimin e vetëqeverisjes lokale. Për më tepër, pritet që nevojat kritike për ndihmë sociale dhe shërbime sociale të rriten, ndërsa njëkohësisht do të ulen të ardhurat e vetëqeverisjeve lokale për funksionet e tyre kryesore dhe ofrimin e shërbimeve themelore.

Situata e këtillë kërkon gjetjen e mënyrave më efikase të cilat do mund të zbatohen në vend; një mënyrë e tillë për tejkalimin e mangësive ekzistuese është aplikimi i bashkëpunimit ndërkomunal (BNK) si një mundësi e dhënë me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Përmes bashkëpunimit ndërkomunal, komunat mund të kryejnë më me sukses kompetencat e tyre, të përmirësojnë cilësinë, efikasitetin dhe efektivitetin e shërbimeve ekzistuese të ofruara për qytetarët, si dhe ofrimin e shërbimeve që ata ndryshe nuk do të ishin në gjendje të ofrojnë vetë. Bashkëpunimi ndërkomunal kontribuon në ekonominë e shkallës, procedura dhe sisteme të shërbimeve më efektive, shfrytëzimin më të mirë të teknologjisë informatike dhe të komunikimit në administrimin e shërbimeve, sigurimin e kapaciteteve të duhura administrative dhe njerëzore dhe kënaqësinë më të mirë të nevojave të qytetarëve.

Në vitin 2009, u miratua Ligji për bashkëpunim ndërkomunal. Sipas këtij ligji, BNK definohet si "bashkëpunim i vendosur midis dy ose më shumë komunave me qëllim të kryerjes më efikase dhe ekonomike të kompetencave të komunave të përcaktuara me ligj dhe për realizimin e interesave dhe qëllimeve të tyre të përbashkëta". Gjithashtu, me bashkëpunimin ndërkomunal nënkuptohet edhe "kryerja e detyrave të caktuara brenda kompetencës së komunave nga ana e një komunë në llogari të një ose më shumë komunave të tjera në bazë të një marrëveshjeje të lidhur midis komunave".

Zbatimi i projekteve të mëparshme për bashkëpunim ndërkomunal nga UNDP në bashkëpunim me Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale (MVL) tregoi se kthimi i investimit fillestar (që rezultojnë kryesisht nga kursimet për shkak të optimizimit të punonjësve, zvogëlimin të kostove operative dhe mirëmbajtjes, rritjes së shkallës së mbledhjes së tatimit, menaxhimit më të mirë, shfrytëzimit më të mirë të pajisjeve dhe ekspertizës) ndodh pas rreth dy vjetësh. Jo më pak i rëndësishëm është fakti që cilësia e përmirësuar e shërbimeve ose vëllimi i rritur i shërbimeve nuk matet gjithmonë përmes mjeteve financiare të shpenzuara ose të kursyera, por edhe përmes kënaqësisë së qytetarëve, përfshirë kategoritë e lëndueshme të qytetarëve.



Republic of North Macedonia
Ministry of
Local Self Government



REVERSING THE COVID CRISIS: MUNICIPALITIES AS DRIVERS OF SUSTAINABLE DEVELOPMENT

Hulumtimi për vlerësimin e përvojave të bashkëpunimit ndërkomunal në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilin e ka realizuar Ministria për vetëqeverisje lokale (MVL) në bashkëpunim me UNDP zbulon se 77.5% e komunave në vend kanë nënshkruar një marrëveshje konkrete për bashkëpunim ndërkomunal, e cila është një bazë e mirë për hapat e mëtejshëm. I njëjti hulumtim nënvizon një numër të madh përfitimesh financiare dhe jofinanciare sidomos për komunat rurale dhe ato të vogla urbane me kapacitet dhe burime të kufizuara. Bashkëpunimi midis komunave duhet të forcohet më tej sepse sjell përfitime të qarta, veçanërisht për komunat e vogla dhe ato rurale.

Në këtë kontekst, UNDP në bashkëpunim me Byronë për zhvillim rajonal dhe Ministrinë e vetëqeverisjes lokale është duke e zbatuar projektin "Pas KOVID: komunat si shtytës të zhvillimit të qëndrueshëm". Qëllimi i projektit është që të sigurojë një zhvillim rajonal dhe lokal gjithëpërfshirës që është i bazuar në prova dhe i ndjeshëm ndaj gjinisë, dhe për të adresuar plotësisht nevojat për zhvillim të komunave më të pazhvilluara, komunitetet e të cilave janë më së shumti të prekura nga pandemia me KOVID-19.

1. Cili është qëllimi kryesor i thirrjes për projekte?

Në kontekstin e mësipërm, e me qëllim për të mbështetur komunat në planin afatgjatë dhe për të forcuar qëndrueshmërinë e sistemeve më të prekura ekonomike lokale, qëllimi i kësaj thirrjeje është të mbështesë përpjekjet **për të përshpejtuar rimëkëmbjen nga recesioni i shkaktuar nga KOVID-19 duke prezantuar vegla inovative për zhvillim rajonal, duke u përqëndruar në zonat më të pazhvilluara dhe modelet e përmirësuara të bashkëpunimit ndërkomunal**, me çka do të kontribuohet për shërbime më të mira lokale, duke siguruar modele për replikime në të ardhmen në vend, dhe kështu do të kontribuohet në një zhvillim të barabartë dhe gjithëpërfshirës për një kohë të gjatë. Gjithashtu, përdorimi i kufizuar i mjeteve dhe shërbimeve dixhitale para pandemisë i pengonte mundësitë e qeverive lokale për të zbutur në mënyrë efektive ndikimin negativ të krizës në planifikimin financiar lokal dhe ofrimin e shërbimeve. Ndërhyrja e propozuar adreson këto çështje duke **mbështetur qeveritë lokale për të futur dhe përdorur platforma inovative dixhitale që u mundësojnë atyre të punojnë në distancë dhe të prezantojnë shërbime të reja dixhitale**.

Qëllimi i thirrjes për projekte është të sigurojë mbështetje për forcimin e kapaciteteve të njësive të vetëqeverisjes lokale duke mbështetur modele inovative të bashkëpunimit të përcaktuara në Ligjin për vetëqeverisje lokale si dhe/ose format ekzistuese ligjore të BNK-së si një mjet për zbatimin e politikave për zhvillim rajonal dhe ofrimin e përmirësuar të shërbimeve për qytetarët. Për më tepër, me qëllim që të mbështetet përmirësimi i parajlmëruar i kornizës së përgjithshme ligjore për BNK, përmes vendosjes, funksionimit dhe analizës së rezultateve të arritura të modeleve inovative të BNK, do të kontribuohet në përgatitjen e një vlerësimi gjithëpërfshirës për mundësinë e zgjerimit të numrit ekzistues të formave të BNK-së si dhe në ndryshimin dhe plotësimin e elementeve të tjera përkatës të Ligjit.

Përmes kësaj thirrjeje publike, njësitë e vetëqeverisjes lokale do të inkurajohen të identifikojnë ide të reja kreative për partneritete ku do të propozohen zgjidhje inovative për sfidat specifike në bashkësi.



Republic of North Macedonia
Ministry of
Local Self Government



REVERSING THE COVID CRISIS: MUNICIPALITIES AS DRIVERS OF SUSTAINABLE DEVELOPMENT

2. Cilat janë fushat prioritare dhe format e pranueshme të bashkëpunimit ndërkomunal në kuadër të kësaj thirrjeje?

Kjo thirrje për projekte do të mbështesë zhvillimin dhe testimin e formave inovative të bashkëpunimit ndërkomunal si një mjet për zbatimin e politikës së zhvillimit rajonal dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët.

Fushat prioritare në të cilat komunat do të mbështeten për të vendosur bashkëpunimin ndërkomunal janë: menaxhimi financiar, mbrojtja e mjedisit jetësor, transporti, zvogëlimi i rrezikut nga katastrofat dhe fusha të tjera që tradicionalisht janë lëndë për zhvillim rajonal të BE-së, dhe me të cilat BNK në mënyrë të konsiderueshme mund të zvogëlohen kostot e shërbimeve për qytetarët, si edhe për buxhetet komunale.

Në kuadër të kësaj thirrjeje, komunat mund të aplikojnë dhe do të mbështeten për të zbatuar projekte pilot në lidhje me **barazinë gjinore** dhe problemet e identifikuara në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse. Fokus i veçantë do të vendoset te **inovacionet në ofrimin e shërbimeve lokale në nivelin teknologjik**, që do të kontribuojnë në shfrytëzimin e mundësive të krijuara nga **dixhitalizimi** dhe do të rrisin bashkëpunimin ndërkomunal dhe përfitimet e efikasitetit në një nivel të ri. Modelet e zhvilluara për bashkëpunimin ndërkomunal, pas pilotimit të suksesshëm në projekt, do të jenë në gjendje të replikohen përtej komunave të zgjedhura fillimisht, në pjesë të tjera të vendit.

Për më tepër, format inovative dhe tradicionale të bashkëpunimit ndërkomunal do të mbështeten edhe në fusha të tjera që janë në kompetencë të njësisve të vetëqeverisjes lokale.

3. Kush mund të aplikojë?

Aplikantët e pranueshëm për këtë thirrje janë njësitë e vetëqeverisjes lokale (komunat dhe Qyteti i Shkupit) në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

3.1 Kush nuk mund të aplikojë?

Organizatat fitimprurëse, respektivisht kompanitë nga sektori privat (firma këshilluese, ndërmarrje individuale, individë, etj.) si dhe organe të administratës shtetërore (ministri, agjenci, etj.), fondacione dhe odat rajonale ekonomike dhe organizata të tjera të ngjashme nuk janë aplikantë të kualifikuar për këtë thirrje. Prandaj, nuk do të pranohen aplikacionet e paraqitura nga komuna/komunat që do të aplikojnë së bashku me një ose më shumë partnerë nga kategoritë e mësipërme.

3.2 Çështje të tjera në lidhje me pranueshmërinë e aplikuesve

Grantet janë të disponueshme vetëm për projekte qëllimet e menjëhershme të të cilave janë jo-komerciale dhe ekskluzivisht jofitimprurëse. Në asnjë rast granti nuk duhet të kontribuojë në rritjen e fitimit.



Republic of North Macedonia
**Ministry of
Local Self Government**



REVERSING THE COVID CRISIS: MUNICIPALITIES AS DRIVERS OF SUSTAINABLE DEVELOPMENT

Projekti duhet të përfshijë të paktën dy komuna. Gjithmonë caktohet një komunë e cila do të jetë aplikuesi kryesor në mes të komunave (aplikuesi kryesor). Komuna që do të caktohet si aplikanti kryesor është përgjegjëse për koordinimin dhe drejtimin e projektit dhe komunikimin me UNDP. Nëse zgjidhet një projekt, të gjitha komunat e përfshira nënshkruajnë një Marrëveshje Bashkëpunimi me zyrën e UNDP.

Një komunë mund të marrë pjesë në vetëm një projekt. Nëse komuna aplikon për pjesëmarrje në më shumë se një projekt, të njëjtat projekte do të përjashtohen automatikisht nga procesi i përzgjedhjes.

Qyteti i Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale në rolin e aplikuesit kryesor mund të aplikojë vetëm me një propozim. Për më tepër, Qyteti i Shkupit mund të aplikojë si partner i secilës prej komunave në kuadër të Qytetit të Shkupit.

Qendrat për zhvillimin e rajoneve planore mund të marrin pjesë në aplikacionin e projektit, por nuk mund të emërohen si aplikues kryesorë ose partnerë në bashkëpunimin ndërkomunal. Qendrat për zhvillimin e rajoneve planore mund të kenë një rol koordinues dhe/ose të mbështesin zbatimin e projektit. Roli i Qendrave për zhvillimin e rajoneve planore duhet të përcaktohet qartë në aplikacionin e projektit. Qendrat për zhvillimin e rajoneve planore mund të marrin pjesë në më shumë se një aplikim.

Gjithashtu, në realizimin e aktiviteteve të parashikuara në kuadër të bashkëpunimit, mund të përfshihen **organizatat e shoqërisë civile** aktive në fushën në të cilën komunat vendosin bashkëpunimin ndërkomunal. Organizatat e shoqërisë civile mund të kenë një rol koordinues dhe/ose të mbështesin projektin, respektivisht, mund të angazhohen në ofrimin e shërbimeve që janë në kompetencë të komunave që e vendosin bashkëpunimin ndërkomunal. Roli i organizatave të shoqërisë civile duhet të përcaktohet qartë në aplikacionin e projektit. Organizatat e shoqërisë civile mund të marrin pjesë në më shumë se një aplikacion.

Të gjitha aplikacionet duhet të përmbajnë Deklaratë për partneritet të nënshkruar nga kryetarët e komunave dhe kryetarët e këshillave të të gjitha komunave të përfshira në BNK (Shtojca 1 e aplikimit). Nëse projekti zgjidhet për financim, me këtë deklaratë për partneritet, nënshkruarit në fjalë deklarojnë se në rast të një propozimi për krijimin e një prej formave të BNK-së nga neni 9 i Ligjit të BNK, e njëjta do të vendoset formalisht në përputhje me Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal (neni 4 deri 8).

Për më tepër, në shtojcë të aplikacionit shtohet edhe Letra për obligim (Shtojca 2 e aplikimit) e nënshkruar nga kryetarët e komunave dhe Kryetarët e këshillave të komunave të të gjitha komunave të përfshira në BNK. Në rast të përfshirjes së Qendrave për zhvillim të rajoneve planore dhe/ose organizatave të shoqërisë civile, një Letër për obligim duhet të nënshkruhet nga kryetari i Këshillit të rajonit planor ose Kryetarit të organizatës së shoqërisë civile.

4. Sa është kohëzgjatja e projektit?

Kohëzgjatja për të cilën projekti “Pas KOVID: Komunat si shtytës të zhvillimit të qëndrueshëm” do të mbështesë komunat në vendosjen dhe funksionalizimin e bashkëpunimit ndërkomunal brenda kësaj thirrjeje është **9 (nëntë) muaj**. Pritet që partneritetet e krijuara midis komunave të zgjasin edhe pas përfundimit të mbështetjes së projektit, për të cilën partneritetet më afatgjate do të vlerësohen me një numër më të lartë pikësh në procesin e evaluimit dhe përzgjedhjes.

REVERSING THE COVID CRISIS: MUNICIPALITIES AS DRIVERS OF SUSTAINABLE DEVELOPMENT

5. Shuma e mjeteve të qasshme në kuadër të thirrjes?

Shuma totale për këtë thirrje është 350,000 USD. Mjetet janë siguruar nga UNDP dhe Byroja për Zhvillim Rajonal të RMV.

NJVL-të e interesuara mund të parashtrorjnë aplikacion në shumë prej 30,000 deri 50,000 USD.

6. Cila është korniza kohore për thirrjen?

Tabela në vijim jep një pasqyrë të orarit për zbatimin e granteve të projekteve për vitin 2021-2022.

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor
1.	Shpallja e thirrjes	13 korrik 2021
2.	Realizimi i 8 info sesioneve në të gjitha rajonet planore	19 – 23 korrik 2021
2.	Afati përfundimtarë për dorëzimin e aplikacioneve	13 gusht 2021
3.	Evalrimi dhe përzgjedhja	20 gusht 2021
4.	Përputhshmëria dhe lidhja e marrëveshjeve	30 gusht 2021
5.	Fillimi i realizimit të projekteve	1 shtator 2021
7.	Mbarimi i realizimit të projekteve	31 Maj 2022
8.	Evalrimi, mësimet e nxjerra dhe shpërndarja e rezultateve	31 Maj 2022

7. Ku të dërgoni aplikacionin?

Komunat që shprehin interes për të paraqitur një propozim projekt për bashkëpunim ndërkomunal duhet të paraqesin një dosje të kompletuar të projektit në përputhje me Udhëzimet operative për Aplikim dhe kërkesat e përfshira në Formularit për aplikim. Aplikimet duhet të dorëzohen në gjuhën maqedonase ose shqipe. Në rast të paraqitjes së një aplikacioni në gjuhën shqipe, nevojitet që të dërgoni edhe përkthimin e aplikacionit në gjuhën maqedonase.

Aplikacionet dorëzohen në mënyrë elektronike, me email në adresën e mëposhtme të postës elektronike:

ivana.petrovska@undp.org më së voni deri më 13 gusht 2021 në ora 14:00.

Pranimi i secilit aplikacion do të konfirmohet me një email kthyes nga UNDP brenda 24 orëve nga paraqitja e tij. Në rast të mos marrjes së konfirmimit kthyes nga ana e UNDP, e me qëllim për të shmangur gabimet e mundshme teknike, duhet të paraqisni përsëri aplikacionin ose të kontaktoni personin përgjegjës të projektit përmes postës elektronike ivana.petrovska@undp.org për të konfirmuar statusin e aplikimit tuaj.

Asnjë aplikacion nuk do të pranohet pas skadimit të afatit.

Të gjitha pyetjet në lidhje me procedurën e aplikimit do të pranohen vetëm me shkrim përmes emailit. Personi për kontakt: Ivana Petrovska: ivana.petrovska@undp.org.

Përgjigjet e pyetjeve të parashtruara do të bëhen publike çdo të hënë (13 korrik - 13 gusht) në faqen e internetit të Byrosë për zhvillimin rajonal dhe Qendrave për zhvillimin e rajoneve planore.

REVERSING THE COVID CRISIS: MUNICIPALITIES AS DRIVERS OF SUSTAINABLE DEVELOPMENT

8. Cilat lloje të projekteve për bashkëpunimit ndërkomunal nuk financohen?

Llojet e mëposhtme të projekteve **nuk janë të pranueshme** për financim dhe për këtë arsye nuk mund të fitojnë mjete:

- Projektet që nuk i referohen ndërtimit të kapaciteteve të njësive të vetëqeverisjes lokale për kryerjen e kompetencave të tyre dhe për ofrimin e shërbimeve publike.
- Projektet që nuk përfshijnë dy ose më shumë njësi të qeverisjes lokale.
- Projektet që janë në fusha që nuk janë në kompetencë të njësive të vetëqeverisjes lokale.
- Financimi retroaktiv i aktiviteteve nga projektet që tashmë kanë filluar.
- Projektet që përmbajnë veprimtari politike ose ideologjike ose kanë natyrë ekskluzivisht fetare. Përdorimi i grantit për të siguruar grante ose hua për persona të tjerë juridikë.
- Themelimin e ndërmarrjeve private.
- Konferenca dhe/ose seminare një herë (konferencat dhe/ose punëtoritë financohen ekskluzivisht nëse ato janë pjesë e aktiviteteve më të gjera të cilat realizohen gjatë kohëzgjatjes së projektit të propozuar). Në këtë drejtim, shtypja e materialeve për konferenca dhe/ose seminare që nuk janë brenda aktiviteteve të miratuara nuk janë të përshtatshme për financim.
- Projektet që kanë të bëjnë ekskluzivisht me prokurimin e pajisjeve ose punëve të infrastrukturës.
- Projektet që kanë të bëjnë ekskluzivisht me prokurimin e tokës, ndërtesave ose zyrave.

9. Cilat shpenzime janë të pranueshme?

Për shpenzime të pranueshme, të cilat do të paraqiten në buxhetin e aplikacionit (brenda tre zërave kryesorë të buxhetit), konsiderohen si më poshtë:

I. Kostot për konsulentët e jashtëm (ekspertë individualë, firma këshillimi, etj.)

- honorare dhe mëditje për angazhim të konsulentëve të jashtëm

II Kostot e operimit

- udhëtim dhe akomodim
- përkthim
- dokumentacione dhe botimet
- kostot për ngjarjet (trajtime, punëtori, ngjarje promovuese, etj.)

III Kostot e investimit

- IT pajisje (hardver dhe softuer)
- Mobilje dhe pajisje për zyre dhe
- Shpenzime të vogla infrastrukturore (riparimi i dyerve, dritareve, kyçje, kablllove, etj.)
- të tjera, etj.

9.1 Kofinancimi nga ana e NjVL

Kofinancimi nga ana e aplikuesve (NJVL) **nuk është i detyrueshëm**. Kofinancimi me të mira dhe shërbime (pjesëmarrja in kind) mund të jetë në formën e pagave për punonjësit në komunë (për stafin e përfshirë në projekt), qiraja e lokaleve për nevojat e projektit, shpenzime operative (shpenzimet e telekomunikimit,

Jordan Hadzi Konstantinov- Dzinot 23, 1000 Skopje, Tel: +389 2 3249 500, Fax: +389 2 3249 505,

email: registry.mk@undp.org; web: www.mk.undp.org



Republic of North Macedonia
**Ministry of
Local Self Government**



REVERSING THE COVID CRISIS: MUNICIPALITIES AS DRIVERS OF SUSTAINABLE DEVELOPMENT

energija elektrike, etj.). Aplikuesit të cilët do të paraqesin kofinancim shtesë me para do të marrin pikë shtesë gjatë evaluimit.

Mjetet financiare që NJVL-të e zgjedhura do ti fitojnë në kuadër të kësaj thirrjeje, në mënyrë administrative, do të menaxhohen nga UNDP. Në rast se aplikuesit kofinancojnë me mjete financiare shtesë, të njëjtat do të transferohen në llogarinë e UNDP për të cilën do të nënshkruhet një marrëveshje e veçantë midis UNDP dhe NJVL-aplikuesit kryesor.

Kofinancimin e mbulojnë komunat partnere. Shuma e kontributit që secili partner do të ofrojë varet nga marrëveshja e arritur midis partnerëve. Komuna- aplikuesi kryesor, por gjithashtu edhe komunat partnere, nënshkruajnë Letrën e kërkuar obligim (kryetarë të komunave dhe kryetarë të këshillave të komunave nga komunat e përfshira në partneritet), duke theksuar shumën e kofinancimit të siguar nga partneriteti, të ndarë në para të gatshme, të mira dhe shërbime. Në rast se një komunë e caktuar nuk është në gjendje të kontribuojë në partneritet me para ose të mira dhe shërbime dhe nëse një pjesë e komunës është e mbuluar përmes kontributeve të duhura nga një ose më shumë partnerë nga partneriteti, në atë rast Letra për obligim e kësaj komuna do të nënshkruhet nga kryetari i komunës dhe kryetari i këshillit të komunës pa e përmendur shumën për kofinancim.

Meqenëse kontributi në të mira dhe shërbime është shpenzimi të cilin e përballojnë aplikuesit, i njëjti duhet të deklarohet në buxhet të veçantë dhe për këtë duhet të sigurohen detajet e kontributit në të mira dhe shërbime, si dhe kontributi në para të gatshme, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Aplikim, i cili gjithashtu do të jetë subjekt i shqyrtimit nga ekipi i vlerësimit të BNK-së.

9.2 Pjesëmarrja e Qendrave për zhvillim të rajoneve planore

Qendrat për zhvillimin e rajoneve planore gjithashtu mund të marrin pjesë në kofinancojnë në të mira dhe shërbime (in kind). Kofinancimi në të mira dhe shërbime mund të jetë në formën e pagave të stafit (të përfshirë në realizimin e projektit), marrjes me qira të lokaleve të cilat përdoren për këtë projekt dhe shpenzimeve operativ (energji elektrike, ujë, shërbime të telekomunikacionit, ngrohje, etj.)

10. Lidhja e kontratave me persona të jashtëm / operatorë ekonomik

Aplikacionet të cilat do të përzgjidhen për mbështetje, do të realizohen nga ana e të punësuarve në komuna dhe institucionet/organizatat në bashkëpunim me ekipin e projektit dhe përfaqësuesit e Byrosë për zhvillim raonal dhe Ministrisë për vetëqeverisje lokale. Në rastet kur komunat partnere kanë nevojë të përfshijnë ekspertë të jashtëm për detyra specifike, do të lidhen kontrata për realizimin e detyrave të këtylla me ekspertë të jashtëm (të vendit dhe të huaj). Cili do qoftë aktivitet për të cilin propozohet lidhja e kontratës duhet të sqarohet në mënyrë të detajuar në Aplikacion.

10.1 Të punësuarit në komuna/qendrat

Të punësuarit në komuna dhe në Qendrat për zhvillim të rajoneve planore/organizatat e shoqërisë civile që marrin pjesë në projekt në asnjë rast nuk mund të marrin kompensim për kryerjen e detyrave për realizimin e projektit. Pjesëmarrja e tyre do të konsiderohet si kofinancim me të mira dhe shërbime (in kind) brenda bashkëpunimit të propozuar.

REVERSING THE COVID CRISIS: MUNICIPALITIES AS DRIVERS OF SUSTAINABLE DEVELOPMENT

10.2 Konsulent të jashtëm

Nëpunësit shtetërorë nga komuna të tjera dhe Qendrat për zhvillimin e rajoneve planore/organizatave të shoqërisë civile që nuk janë pjesë e projektit mund të angazhohen si trajnues/konsulentë në përputhje me legjislacionin kombëtar. Konsulentë të pavarur (ekspertë, firma këshilluese ose organizatave të shoqërisë civile) dhe profesionistë të tjerë mund të angazhohen. Pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile është e mundur vetëm në rastet kur organizata ka përvojë përkatëse në temat prioritare të projektit dhe mund të ketë vlerë të shtuar në propozim projektin. Pjesëmarrja e tyre duhet të shpjegohet në mënyrë adekuate në aplikacion.

11. Shpenzime të cilat nuk mbulohen me grantin

Shpenzimet të cilat janë cekur më poshtë nuk mbulohen nga projektet nga kjo thirrje:

- Shpenzime për TVSH
- Rroga për nëpunësit shtetëror dhe të punësuarit në komunat parashtruese dhe partnere. Kontributi i tyre në projekt do të konsiderohet si kontribut në shërbime nga komunat parashtruese dhe/ose partnere
- Tatim personal për individët të cilët janë të angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projektit.

12. Evaluimi i projekteve për bashkëpunimit ndërkomunal

Për të kryer evaluimin dhe përzgjedhjen e aplikacioneve të paraqitura për bashkëpunim ndërkomunal, formohet ekipi për evaluim. Ekipin e përbëjnë dy anëtarë nga UNDP dhe një anëtar - përfaqësues i Byrosë për zhvillim rajonal. Në rolin e vëzhguesve, një përfaqësues nga Ministria e vetëqeverisjes lokale dhe BNJVL do të ftohen në punën e ekipit për evaluim. Ekipi i evaluimit të projekteve për BNK ka sekretar i cili përgatit procesin e evaluimit dhe përzgjedhjes dhe mban procesverbal për procesin. Sekretari i ekipit të evaluimit dhe përzgjedhjes së projekteve për bashkëpunim ndërkomunal është anëtar i ekipit të Programit për BNK të UNDP-së.

Evaluimi i propozimeve bëhet në dy faza.

(a) Faza e paraselektimit: kjo përfaqëson fazën e parë në procesin e evaluimit. Përbëhet nga verifikimi i aplikimeve të fituara për përshtatshmëri nga aspekti administrativ, në bazë të listës për evaluim (shih 17.1).

(b) Faza e selektimit: Aplikacionet të cilat do të kalojnë fazën e paraselektimit vazhdojnë me verifikimin e aspekteve teknike, në bazë të tabelës për evaluim të përshtatshmërisë teknike (shih 17.2). Ekipi për evaluim i vlerëson aplikacionet me dhënien e pikave pyetjeve të caktuara – kriteret teknike për evaluim.

13. Si është e organizuar procedura për evaluim dhe zgjedhje?

- UNDP i evidenton të gjitha propozim projektet të cilat arrijnë.
- Anëtarët e ekipit për evaluim nënshkruajnë letër për paanshmëri para se të filloj procesi i evaluimit.
- Ekipi për evaluim është përgjegjës për evaluim të propozimeve nga aspekti i pranueshmërisë administrative dhe për evaluimin e kualitetit teknik dhe financiar të propozimeve.
- Ekipi për evaluim e vlerëson çdo propozim në bazë të kriteriumeve për evaluim (seksioni 17), mban Procesverbal dhe i sjell rekomandimet dhe vendimet e veta në formë të raportit nga evaluimi.



BUREAU FOR REGIONAL DEVELOPMENT



Republic of North Macedonia

Ministry of
Local Self Government



REVERSING THE COVID CRISIS: MUNICIPALITIES AS DRIVERS OF SUSTAINABLE DEVELOPMENT

- Raporti nga evaluimi dërgohet deri te Këshilli i projektit për miratim.
- UNDP ka të drejtë të kërkoj nga parashtruesit e suksesshëm të bëjnë modifikime të propozimeve të tyre (modifikime të buxhetit dhe aktiviteteve) në përputhje me standardet e UNDP para se të hyjnë në lidhje të kontratës me komunat konkrete.
- UNDP i njofton me shkrim të gjithë parashtruesit për rezultatet nga procesi i evaluimit dhe zgjedhjes.
- Rezultatet finale për procesin e selektimit do të shpallën publikisht ne ueb faqen e Byrosë për zhvillim rajonal dhe UNDP-së.

14. Modalitetet për realizimin e projektit

UNDP do të nënshkruajë një marrëveshje bashkëpunimi për projektin me komunat e zgjedhura. Gjuha e kontratës është anglishtja. Fillimi zyrtar i projekteve është shtatori i vitit 2021.

Të gjitha shpenzimet e parashikuara në projekt do të paguhen direkt nga UNDP. Marrëveshja për bashkëpunim për projektin nuk parashikon transferin e mjeteve nga UNDP deri te komunat e selektuara. Aplikuesi kryesor e ka përgjegjësinë për realizimin e projektit dhe realizimin e aktiviteteve. Komuna udhëheqëse do të marrë pjesë në përmbushjen e përgjegjësi administrative dhe financiare për realizimin e projektit. Komuna udhëheqëse do të jetë përgjegjëse për dorëzimin e raporteve të projektit.

15. Menaxhimi dhe monitorimi

Me fillimin e implementimit të projektit, ekipi i Programit për BNK e kryen monitorimin dhe evaluimin e implementimit.

Ekipi i Programit për BNK e kryen koordinimin dhe merr pjesë në vizitat monitoruese, i pranon dhe vlerëson raportet e kërkuara të projektit, dhe i miraton raportet përfundimtare. Raportet që janë të rëndësishme për vendimmarrje në lidhje me përparimin ose finalizimin e projekteve dorëzohen të Këshilli i projektit për aprovim.

Ekipi i Programit të BNK-së në bashkëpunim me Byronë për zhvillim rajonal dhe Ministrinë e vetëqeverisjes lokale organizojnë vizita në terren me qëllim që të ofrojnë mbështetje profesionale të monitorojnë nga afër zbatimin e projekteve.

Procesi i monitorimit dhe raportimit kryhet sipas procedurave standarde. Monitorimi dhe evaluimi i projektit bazohet në një vlerësim mujor për progresin e ofrimit të të rezultateve/aktiviteteve specifike dhe arritjen e qëllimeve të projektit. Të gjitha raportet dorëzohen deri te UNDP – Programi për BNK.

Një bazë e të dhënave e projekteve për BNK do të krijohet që nga fillimi i thirrjes për propozime. Kjo bazë e të dhënave do të jetë një mjet për menaxhimin dhe monitorimin e procesit të implementimit. Të gjitha aplikacionet të cilat do të arrijnë, projektet e zgjedhura dhe raportet do të jenë pjesë e kësaj baze të të dhënave.

Për më tepër, ekipi i Programit të BNK kryen detyrat në vijim:

- Merr pjesë në promovimin dhe ngritjen e vetëdijes për projektin në të gjitha mënyrat e mundshme, në bashkëpunim me partnerët e përfshirë në projekt.
- Siguron mbështetje dhe ndihmë në procesin e përgatitjes së propozimeve për të gjithë ata që do të kërkojnë ndihmë, veçanërisht për komunat me kapacitete më të ulëta.

Jordan Hadzi Konstantinov- Dzinot 23, 1000 Skopje, Tel: +389 2 3249 500, Fax: +389 2 3249 505,
email: registry.mk@undp.org; web: www.mk.undp.org

REVERSING THE COVID CRISIS: MUNICIPALITIES AS DRIVERS OF SUSTAINABLE DEVELOPMENT

- Jep trajnime për komunat e zgjedhura në fushën e BNK-së.
- Siguron mbështetje në përgatitjen e raporteve të rregullta.
- Kryen monitorimin e realizimit të aktiviteteve të miratuara të projektit.
- Kryen integrimin efektiv të informacioneve të projektit në bazën e të dhënave për BNK.
- Zbaton procedurat e prokurimit publik dhe paguan furnitorët.

16. Cilat janë obligimet në lidhje me parashtrimin e raporteve?

Komuna që është aplikuesi kryesor është e obliguar që të paraqesë raportet e mëposhtme:

- Raportin mujor
- Raportin afatmesëm
- Raportin përfundimtar i dorëzuar pas përfundimit të projektit.

Programi i UNDP për bashkëpunim ndërkomunal, projekte të suksesshme ju siguron kopjen e formularëve për përgatitjen e raporteve të mësipërme në përputhje me procedurat dhe kërkesat e brendshme.

17. Kriteret për evaluim dhe zgjedhje të aplikacioneve të parashtruara

Ekipi i evaluimit i shqyrton të gjitha propozimet e pranuar në përputhje me kriteret e përshkruara më poshtë. Evaluimi i aplikacioneve kryhet në dy faza:

- Përshtatshmëria administrative dhe
- Përshtatshmëria teknike.

17.1 Përshtatshmëria administrative

Që projekti të pranohet administrativisht, është e nevojshme ti plotësoje kriteret e mëposhtme:

1. A janë të gjithë aplikuesit njësi të vetëqeverisjes lokale?
2. A përfshin projekti për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal partneritet të dy ose më shumë komunave?
3. A ka dorëzuar komuna vetëm një propozim si një aplikues kryesor ose si një komunë partnere? *
4. A shoqërohet aplikacioni me një Deklaratë për partneritet (si Shtojcë 1 e veçantë e aplikacionit) e nënshkruar nga kryetarët e komunave dhe kryetarët e këshillave të komunave dhe e vulosur nga komuna? Ku propozohet përfshirja e Qendrave për zhvillim të rajoneve planore dhe/ose e organizatave të shoqërisë civile, a shoqërohet aplikacioni me një deklaratë për partneritet të nënshkruar nga Kryetari i Këshillit të rajonit planor dhe Kryetari i organizatës së shoqërisë civile?
5. A e kanë nënshkruar dhe vulosur kryetarët e të gjitha komunave të përfshira në bashkëpunim Letrën për obligim (e cila parashtrohet si Shtojcë 2 e veçantë e aplikacionit) ku deklarohen se të gjitha aktivitetet e ndërmarra në lidhje me projektin e propozuar janë dhe do të jenë plotësisht në përputhje me legjislacionin vendas?
6. A është projekti brenda qëllimit të thirrjes siç përshkruhet në Udhëzimet operative?
7. A është bashkëpunimi i propozuar ndërkomunal një formë inovative e bashkëpunimit apo është një nga format e BNK-së sipas Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal?

REVERSING THE COVID CRISIS: MUNICIPALITIES AS DRIVERS OF SUSTAINABLE DEVELOPMENT

8. Në rast të kofinancimit, a paraqitet qartë shuma totale në Letrën për obligim (Shtojca 2)?
9. A janë të plotësuara të gjitha pjesët e aplikacionit?
10. A është dorëzuar buxheti me një përshkrim të hollësishëm të shpenzimeve dhe arsyetimin e nevojshëm (Shtojca 3)?
11. A është granti i kërkuar i UNDP brenda kufijve të përcaktuar në Udhëzimet operative, dmth. midis \$ 30,000 dhe \$ 50,000?
12. A e respekton projekti i propozuar për bashkëpunim ndërkomunal kohëzgjatjen e dhënë prej 9 (nëntë) muajve për realizimin e projektit?
13. A e kanë plotësuar të gjitha komunat tabelën me të dhënat e disponueshme për Indeksin e zhvillimit komunal ** dhe i parashtrorin ato në shtojcë të aplikacionit si Shtojca 4?

E rëndësishme: Çdo aplikacion që nuk do të jep përgjigje pozitive (PO) për **të gjitha** kriteret e mësipërme të përshtatshmërisë administrative nuk do të konsiderohet për evaluimin e mëtejshëm në fazën e përshtatshmërisë teknike.

* Përrjashtim nga ky rregull është vetëm Qyteti i Shkupit, i cili mund të paraqitet vetëm një herë si parashtrues, por si partner mund të paraqitet në secilën prej komunave nga territori i Qytetit të Shkupit.

** Indeksi i zhvillimit komunal është një mjet i krijuar për të ndihmuar Qeverinë, donatorët dhe palët e tjera të interesit në politikën e zhvillimit rajonal për të përcaktuar gjendjen aktuale të zhvillimit të secilës komunë në Maqedoninë e Veriut. Për më shumë informacion: <https://golocal.mk/mdi/mdi-mk.html>. Dokumenti me instruksione për plotësimin e Indeksit për zhvillim komunal është i dhënë si shtojcë e kësaj thirrjeje.

Një aplikacion i plotë duhet të përmbajë pjesët e mëposhtme:

- Formularin e plotësuar të aplikimit i cili përfshinë:
 - a) Deklarata e Partneritetit e nënshkruar nga kryetarët e këshillave të komunave dhe kryetarët e komunave dhe e vulosur nga komuna (kur është e përshtatshme nga kryetari i Këshillit të rajonit planor dhe/ose kryetari i organizatës së shoqërisë civile (Shtojca 1)
 - b) Letër për obligim e nënshkruar nga të gjithë kryetarët e komunave dhe kryetarët e këshillave të komunave (Shtojca 2)
- Buxheti i kompletuar dhe arsyetim për buxhetin (Shtojca 3)
- Formular i plotësuar për Indeksin e zhvillimit komunal për secilën komunë të përfshirë në bashkëpunim (Shtojca 4)

17.2 Përshtatshmëria teknike

Aplikacionet të cilat e kanë kaluar përshtatshmërinë administrative do të vlerësohen për përshtatshmërinë e tyre teknike (thelbësore) sipas kriterëve dhe pikave të përcaktuara, siç përcaktohet më poshtë në kriteret për evaluim. Numri maksimal i pikëve që aplikacionet mund të arrijnë është 100. Vetëm aplikacionet që kanë fituar një minimum prej 60 pikësh do të konsiderohen për përzgjedhje, sipas renditjes.



BUREAU FOR REGIONAL DEVELOPMENT



Republic of North Macedonia

Ministry of
Local Self Government**REVERSING THE COVID CRISIS: MUNICIPALITIES AS DRIVERS OF SUSTAINABLE DEVELOPMENT****KRITERET PËR EVALUIM**

Seksioni	Pikët maksimale	Formulari për aplikim
1. Kapaciteti operativ dhe administrativ për menaxhim	Maks.10	
1.1 A tregojnë komuna aplikuese dhe partnerët përvojë në menaxhimin dhe e projekteve (përfshirë stafin, pajisjet dhe aftësinë për të menaxhuar projektin?) dhe kapacitetin administrativ dhe financiar?	5	A1 dhe A2
1.2. Sa NJVL dhe palë të tjera të interesit janë të përfshira në bashkëpunim?	5	
2. Relevanca e projektit	Maks.30	
2.1 Sa është relevant projekti për qëllimet e kësaj thirrje?	6	C.1 dhe C.2
2.2 A ka të bëjë projektin me temat prioritare për këtë thirrje?	6	C.1 dhe C.2
2.3 Sa është relevant ky projekt për nevojat dhe sfidat e komunave?	6	C.1 dhe C.2
2.4 Si do të kontribuojnë rezultatet e bashkëpunimit në tejkalimin e pengesave ekzistuese ?	6	C.4
2.5 A janë përzgjedhur NJVL-të dhe palët e tjera të interesuara strategjikisht dhe me role qartë të përcaktuar në bashkëpunimin e propozuar?	6	C.1 dhe C.2
3. Metodologjia	Maks.10	
3.1 A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhje me objektivat dhe rezultatet e pritura?	7	C.3
3.2 A është i qartë dhe real afati kohor për realizimin e projektit?	3	C.3.1
4. Përfitimet-ndikimi-qëndrueshmëria	Maks. 30	
4.1 A ka përfitime të elaboruara afatshkurtëra dhe afatgjate nga propozim projekti?	10	C.6
4.2 A është bashkëpunimi i propozuar një zgjidhje inovative për tejkalimin e sfidave të njësisë të vetëqeverisjes lokale dhe a do të gjenerojë kursime të shpenzimeve (afatshkurtra dhe afatgjate) në buxhetet komunale? A janë bashkangjitur të dhëna kuantitative?	5	C.6
4.3 A janë të qëndrueshme rezultatet e pritshme të propozimit: - financiarisht (si do të finanohet bashkëpunimi pas përfundimit të financimit të projektit)? - institucionalisht (a do të mundësojë forma e zgjedhur e bashkëpunimit aktivitetet të vazhdojnë pas përfundimit të grantit? A do të ketë "pronësi lokale" të rezultateve të projektit)?	10	C.7
4.4 A ka nevojë dhe mundësi për të zgjeruar bashkëpunimin e NJVL-ve edhe në fusha të tjera brenda kompetencës së saj?	5	C.7
5. Buxheti dhe efektiviteti i shpenzimeve	Maks.5	
5.1 A kofinancohet projekti nga NJVL-të?	5	C.8 dhe buxheti
6. Çështje të tjera	Maks.15	
6.1 A ofron projekti zgjidhje dixhitale për probleme të caktuara?	8	C 9
6.2 Sipas Indeksit të zhvillimit komunal, në cilën kategori të zhvillimit bëjnë pjesë NJVL-të e përfshira në bashkëpunim?	4	Shtojca 4
6.3. A i merr parasysh bashkëpunimi çështjet gjinore?	3	C 9
Maksimumi i pikëve	100	